

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU
-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------

ASC-09-0091

Në padinë e

██████████, Skenderaj

Ankuesja/Apeluesja

██████████

Kundër

1. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit

Të Paditurat

e përfaqësuar nga Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut

2. Agjencia Kosovare e Privatizimit

Ilir Konushevci 8, Prishtinë

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS) i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 qershor 2010, lëshon këtë

AKTVENDIM

- 1. Ankesa deri më tani është e bazuar pasi që anulohet aktvendimi i Trupit Gjykues të DHPGJS-së i datës 15 tetor 2009, SCEL-08-005.**
- 2. Urdhërohet Trupi Gjykues që të rigjykoj padinë.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 5 nëntor 2008, Ankuesja ushtroi ankesë në DHPGJS me të cilën kërkoi të obligohej e Paditura të paguaj kompensimin në vlerë prej 400 eurosh. Ankuesja është ish punëtore e NSH-së [REDACTED] dhe në listën e punëtorëve me të drejtë për pjesëmarrje në 20% e të ardhurave nga privatizimi i asaj ndërmarrje. Ajo pohoi se nuk është trajtuar e barabartë me punëtorët tjerë në listë kur është bërë ndarja e 20% të të ardhurave. Ajo kishte stazh pune prej njëmbëdhjetë vjetësh në shërbim të asaj ndërmarrje, e cila nuk është marrë parasysh në mënyrë të njëjtë sikurse përvoja e punës e punëtorëve tjerë gjatë shpërndarjes së të hyrave.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) e ka kundërshtuar ankesën kryesisht mbi bazën se Ankuesja nuk e ka paraqitur librezën e punës me kohë gjatë procedurës së shpërndarjes së 20% të të hyrave të privatizimit, nga e cila do të mund të vërtetohej stazhi i saj i punës.

Me aktvendimin e datës 15 tetor 2009, Trupi Gjykses i DHPGJS-së e refuzoi ankesën e Ankueses si të papranueshme. Në arsyetimin ligjor të aktvendimit thuhet se DHPGJS-ja nuk ka juridiksion mbi shumën të cilën eventualisht e pranon Ankuesi nga autoriteti i duhur si pjesë e shpërndarjes së 20% nga të hyrat e privatizimit. Për më tepër, ky kalkulim do të ishte tërësisht në duart e Agjencisë.

Më 24 nëntor 2009, Ankuesja (më tej si Apeluesja) parashtroi ankesë kundër atij aktvendimi dhe kërkoi t'i miratohej ankesa.

Më 7 maj 2010, AKP-ja ushtroi një përgjigje dhe kërkoi refuzimin e ankesës së Apelueses si të pathemeltë dhe të pabazuar në ligj, dhe të miratohet aktvendimi i Trupit Gjykses.

Arsyetimi Ligjor:

Ankesa është e pranueshme dhe deri më tani e bazuar pasi që ankesa do të duhet të rigjykohet.

Juridiksioni i DHPGJS-së

Juridiksioni i DHPGJS-së, ashtu siç e ka gjykuar Trupi Gjykses në mënyrë të drejtë, është parakusht për shqyrtimin e ankesës.

Trupi Gjykses gabimisht e ka mohuar juridiksionin e DHPGJS-së në lëndët si kjo në fjalë. Ankesat të cilat bazohen në përgjegjësinë e Agjencisë për të shpërndarë pjesën e duhur të punëtorët me të drejta në të hyrat e privatizimit të ndërmarrjes i përkasin juridiksionit të DHPGJS-së.

Në kohën kur është ushtruar ankesa juridiksioni i DHPGJS-së është përcaktuar në Rregulloren e UNMIK-ut (RREG) 2002/13. Neni 4.1, pika g) e Rregullosës së përmendur përcakton se DHPGJS-ja do të ketë juridiksion parësorë për paditë dhe kundërpaditë në lidhje me çështjet e tilla tjera që mund t'i caktohen me ligj. Neni 10 i RREG të UNMIK-ut 2003/13 merret me të drejtën e punëtorëve për pjesëmarrje në të ardhurat e privatizimit të NSH-ve. Në bazë të nenit 10.6 të RREG të UNMIK-ut 2003/13, pas paraqitjes së kërkesës nga individ apo individët me të drejtë të cenuar, ankesa lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, e përcaktuar nga Agjencia dhe shpërndarja e fondeve nga llogaria e garancimbajtjes e paraparë në paragrafin 10.5, i nënshtrohet shqyrtimit nga DHPGJS-ja, në pajtim me nenin 4.1 (g) të RREG të UNMIK-ut 2002/13.

Në periudhën kur lënda po priste të zgjidhej në Trupin Gjykses, ka hyrë në fuqi RREG e re e UNMIK-ut 2008/4. Neni 4.1 (e) i RREG të UNMIK-ut 2008/4 përcakton se Trupat Gjykses të DHPGJS-së kanë juridiksion parësor për paditë dhe kundërpaditë që lidhen me paditë që kanë të bëjnë me listën zyrtare të punëtorëve që kanë të drejtë të një ndërmarrje të nxjerrë nga agjencia dhe

punëtorët që kanë të drejtë sipas nenit 10 të RREG të UNMIK-ut 2003/13, me ndryshim. Për më tepër, neni 57 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 përveç çështjeve të tjera përmban udhëzime të hollësishme se si duhet të ushtrohet ankesa. Në bazë të nenit 67.6 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 ankesa përveç tjerash duhet të përmbajë "Bazat e detajuara ligjore dhe faktike ku mbështetet kërkesa për përfshirje ose kundërshtim të listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën, të krijuar nga Agjencia apo shpërndarjen e fondeve nga llogaria garanci mbajtëse e paraparë me nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13".

Shpërndarja e pjesës së saktë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së për punëtorin në bazë të nenit 10 të RREG të UNMIK-ut 2003/13 është pjesë qenësore e procedurës së privatizimit. Nuk mund të konkludohet nga ligji se në lidhje me këtë pjesë të rëndësishme të procedurës së privatizimit punëtorët nuk kanë mundësi ligjore të veprojnë kundër aktvendimeve të Agjencisë. Çështja qëndron ndryshe: Agjencia duhet t'i nënshtrohet mekanizmit të kontrollit përfshirë edhe zgjidhjen juridike në gjykatë kur të llogaritet pjesa e drejtë e të hyrave që do t'i shpërndahen punëtorit. Neni 4.1 (e) i RREG të UNMIK-ut 2008/4 në lidhje me nenin 10 të RREG të UNMIK-ut 2003/13 dhe nenin 67.6 të UA-së së UNMIK-ut, prandaj, interpretohen në atë mënyrë që edhe ankesat që kanë të bëjnë me korrektësinë e pjesës së të hyrave që i ndahen punëtorit janë nën juridiksionin e DHPGJS-së.

Kthim i lëndës në rigjykim

Trupi Gjykses e ka hedhë poshtë ankesën si të papranueshme mbi baza jo valide. Prandaj, aktvendimi i atakuar duhet të anulohet dhe të kthehet te Trupi Gjykses për rigjykim. Në këto rrethana, Kolegji i Ankesave nuk ka mundësi të shqyrtojë meritat e ankesës si shkallë e parë dhe nuk mund të marrë qëndrim mbi bazat ligjore të padisë (ASC-09-0100).

Taksat/ shpenzimet gjyqësore:

Procedurat në lëndët që kanë të bëjnë me listat e punëtorëve legjitim (neni 67 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6) janë- me përjashtim të taksave gjyqësore të caktuara që nuk janë relevante këtu – pa pagesë (shih gjithashtu Rregullat Plotësuese Procedurale në lidhje me taksat gjyqësore të lëshuara nga Dhoma e Posaçme, që janë në fuqi nga 10 marsi 2010, në bazë të nenit 57.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6; ASC-09-0060).

Nëse do të dalin shpenzime gjatë procedurës së më tejme (në veçanti në anën e të Paditurës), i mbetet Trupit Gjyqësor që t'i alokojnë këto shpenzime ndërmjet palëve në aktvendimin përfundimtar (shih nenin 11 të RREG 2008/4 dhe nenin 66 të UA-së së UNMIK-ut; krahasoni ASC-09-0060).

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it [nënshkrimi]

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it [nënshkrimi]

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it [nënshkrimi]

Tobias Lapke, Regjistruer i EULEX-it [nënshkrimi]